



VENDIM

Nr. 94 Datë 01.12.2010

**MBI ANKIMIN E CEZ SHPERNDARJE SH.A PER VENDIMIN E
BORDIT TE KOMISIONEREVE NR.90 DATE 15.11.2010**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, te nenit 128, te Ligjit nr.8485, date 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative” nenit 16, te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s, te miratuara me Vendimin nr.18 date 21.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.12.2010, mbasi analizoi kërkesën e CEZ Shperndarje sh.a per ankimin e vendimit nr.90, date 15.11.2010, dhe relacionin e Drejtorise Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit për kete çështje,

Konstaton se:

- CEZ Shperndarje sh.a në kërkesën e saj të datës 19.11.2010, ka riformuluar të njëjtat argumenta që ka paraqitur edhe gjate zhvillimit te mbledhjes se Bordit te Komisionereve te dates 15.11.2010.
- Nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion te ri provues sic percaktohet ne nenin 16 te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE lidhur me praktiken per vendosjen e demit ekonomik
- Sipas kompanise emertimi „Energji e pamatur“ i aplikuar nga CEZ Shperndarje kryhet edhe ne reference te pikes IV.9 te Kodit te Matjes

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi:

- 1- Te mos marre parasysh pretendimet e CEZ Shperndarje, te paraqitura ne ankesen e CEZ Shperndarje date 18.11.2010, dhe 23.11.2010, per piken 1 te vendimit, nr.90 date 15.11.2010, duke lene ne fuqi pika 1, te Vendimit te Bordit te Komisionereve te ERE nr. 90, date 15.11.2010 “Per denimin me gjobe te CEZ Shperndarje Sh.a. per shkeljet e konstatuara lidhur me moszbatimin nga ana e saj te Vendimeve te ERE-se”.
- 2- Ne piken 2, te vendimit nr.90, date 15.11.2010, behet nje ndryshim duke shtuar pas fjaleve “energjii e pamatur” shprehjen si me poshte:

“Per ato raste kur nuk aplikohet ne zbatim te pikes IV.9 te Kodit te Matjes”.

- 3- Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shperndarje sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.